

20100831497

**L I G J**  
**PËR NGARKIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME HUA TE BANKA**  
**INVESTUESE EVROPIANE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN**  
**“FURNIZIMI ME UJË DHE SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA”**

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet te Banka Investuese Evropiane me hua në shumë prej 50.000.000 eurosh, dedikuar për realizimin e Projektit “Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza”.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen për hua për Projektin “Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza”, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Investuese Evropiane.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar prej tij.

Neni 3

Huaja nga neni 1 i këtij ligji, do të tërhiqet më së shumti në 20 transhe. Shuma minimale e një transhe është 2.000.000 euro.

Afati i pagesës së secilës transhe të huas është 25 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej 5 vitesh, nga dita e tërheqjes së transhesë. Transheja mund të paguhet edhe përnjëherë në ditën që është ndërmjet 3 dhe 15 vitesh nga dita e tërheqjes së transhes.

Neni 4

Shkalla e kamatës dhe afati i pagesës do të përcaktohen për secilën transhe nga huaja në veçanti, në ditën e dorëzimit të kërkesës për tërheqjen e mjeteve nga huaja nga ana e Ministrisë së Financave, varësisht nga ajo se cila shkallë e kamatës është më e volitshme për Republikën e Maqedonisë (fikse ose variable).

Neni 5

Shfrytëzues përfundimtarë të mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji, janë komunat dhe komunat e qytetit të Shkupit, të cilat mjetet do t'i marrin si donacion.

Neni 6

Republika e Maqedonisë, huan nga neni 1 i këtij ligji, do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e ardhshme nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.